

Sistemi Fiskal në funksion të Politikës Sociale

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Sistemi Fiskal në funksion të Politikës Sociale
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Salla D1
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Agim Paca
Detajet kontaktuese:	agim.paca@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<i>Qëllimi i këtij kursi është që studentëve të kursit master të Fakultetit Juridik të ofrojë njohuri mbi Sistemin Fiskal dhe se si i njëjti duhet të jetë në funksion të ushtrimit të përgjegjësive publike – sociale në një vend konkret. Kjo për arsye se shteti bashkëkohor dita ditës është duke zgjeruar përgjegjësitë dhe funksionet që ushtron jo vetëm në jetën ekonomike por edhe atë sociale. Për këtë krijimi dhe zbatimi i politikave sociale është i një rëndësie të jashtëzakonshme për të siguruar realizimin e zhvillimit të domosdoshëm ekonomik dhe social të një vendi (cf. Art. 119 nr.4 i Kushtetutës së Kosovës). Gjatë kësaj shfrytëzimi i mundësive institucionale dhe aplikimi i politikës së sukseseshme fiskale si me rastin e realizimit të të hyrave dhe të dalave, është pjesë përbërse e qeverisjes së mirë dhe bazë themelore për të siguruar realizimin e objektivave siç janë: zhvillimi ekonomik, punësimi i plotë dhe mirëqenja sociale.</i>
Qëllimet e lëndës:	
Rezultatet e pritura të nxënies:	<i>Me ndihmën e ligjeratave, ushtrimeve, prezentimeve praktike, seminareve, punës individuale dhe në grupe, testeve dhe formave të tjera të mësimdhënies dhe të</i>

	<i>punës si dhe vlerësimin korrekt të njohurive gjatë gjithë semestrit, studentët aftësohen që në të ardhmen në mënyrë të pavarur dhe në cilësi të profesionistit të punojnë në të gjitha institucionet financiare në punët dhe detyrat juridiko-financiare.</i>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	1.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	15	75
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			143.5 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Gjatë mësimdhënies do të përdoren metodat bashkëkohore: - Metoda e mësimdhënies aktive; - Metoda e mësimdhënies inter-aktive; - Metoda krahasuese, Metoda e analizës dhe mundësisht trajnimi praktik në institucionet financiare.</i>		
Metodat e vlerësimit:	<p><i>20%: Pjesëmarrja në diskutimet në klasë.</i></p> <p><i>20%: Gjatë semestrit, ne do të mbulojmë disa grupe të problemeve. Secili student do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e një problemi të vendosur gjatë semestrit. Studenti do të shkruajë një punim tre-deri në pesë-faqesh (me hapësirë të dyfishtë mes rreshtave, shkronja 12-pikëshe Times New Roman, margjina e faqes 1 ") duke analizuar problemet.</i></p> <p><i>Studenti do të ketë 10-15 minuta gjatë orës për t'ia shpjeguar klasës problemin dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve. Kjo detyrë do të përfaqësojë 20% të notës së secilit nxënës.</i></p> <p><i>60%: provimi.</i></p>		

Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zaho dhe Brunilda Duraj : Tregjet dhe Institucionet Financiare, Tiranw 2010 2. Jeffrey B. Little dhe Lucien Rhodes: Tw kuptojmw burswn e Vvall Streetit, Tiranw, 2009. 3. Aristotel Pano, Tregu Financiar, Albin, Tiranë 2007; 4. Hreber B. Mayo, Financat. Shtepia Botuese ‘Libri Universitar’ Tiranë 1998; 5. Dr. Safet Merovci, Tregu Financiar, Prishtinë 2004; 6. Frederic S. Mishkin, Stenly G. Eakins, Tregjet dhe Institucionet Financiare ,MATE Zagreb 2005, Botimi i katërt ; 7. Marijan Cvjeticanin, Teknika në Bursa, përkthim shqip, Viktoria Prishtinë, 2008; 8. Ross Cranston, Parimet e së Drejtës Bankare, OUP Oxford, 2002; 9. Parameswaran R, Natarajan S, K P Kandasami, E Drejta Bankare dhe Praktikant, S Chand Group; 10. William A. Lovett, E Drejta Bankare dhe Institucioneve Financiare, West Law School, 7 edition , 2009.
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Tony Golding, The City inside the great Expectitim machin, Printice Holl, second edition ,2003. 2. How the Stock Market Really Works, Pretnice Holl, Forth Etiton, 2001. 3. Bernard G. Foley, Capital markets, Palgrave Macmillan (August 1991) 4. Frederick S. Mishkin, The economics of money, banking and financial markets, 8th edition. Pearson Education Inc. 2007
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Detyrat të financave dhe zhvillimi i saj
Java e dytë:	Interesi publik (shoqëror-social) në procesin e krijimit, të shpërndarjes dhe rishpërndarjes të të ardhurave kombëtare
Java e tretë:	Funksionet publike përmes shpenzimeve publike
Java e katërt:	Shpenzimet publike në funksion të zhvillimit ekonomik dhe të strukturës së ekonomisë

Java e pestë:	<p>Funksionet ekonomike të shpenzimeve publike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Funksioni i alokacionit të resurseve ekonomike - Funksioni i redistribuimit të të ardhurave kombëtare - Funksioni stabilizues <p>Funksioni i krijimit të kushteve për zhvillim stabil ekonomik dhe social .</p>
Java e gjashtë:	<p>Mënyrat dhe metodat e shfrytëzimit të sistemit fiskal në funksion të qëllimeve publike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përvoja me “New Deal”-N - Te dalat publike dhe ndërmarrjet publike ose shtetërore, - Transferët përmes të dalave publike <p>Ndarja e përgjegjësisë publike në mes niveleve të ndryshme të njësive politiko-administrative</p>
Java e shtatë:	<p>Veprimet dhe pasojat inflatore, Antiinflatore, Deflatore dhe Antideflatore të dalave publike</p>
Java e tetë:	<p>Funksionet publike përmes të hyrave publike</p>
Java e nëntë:	<p>Kapaciteti fiskal dhe ngarkesa fiskale</p>
Java e dhjetë:	<p>Elasticiteti i ngarkesës fiskale dhe ndikimi ekonomik dhe social i sajë</p>
Java e njëmbëdhjetë:	<p>Raporti strukturor i të hyrave publike ndaj strukturës ekonomike</p>
Java e dymbëdhjetë:	<p>Emisioni i parasë si burim i të hyrave publike</p>
Java e trembëdhjetë:	<p>Pse qeveritë aprovojnë një buxhet vjetor</p> <p>Sistemi Fiskal i Republikës së Kosovë dhe funksionet sociale të saja .</p>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vonesa në ligjerata dhe ushtrime; • Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);

- *Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimit;*
- *Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.*

Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:

- *Kopjimi gjatë provimit ose testit;*
- *Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;*
- *Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;*
- *Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.*